

**VENDIM**  
**Nr. 382, datë 6.5.2015**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 710, DATË 29.10.2014, TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE, “PËR KUOTAT FINANCIARE TË USHQIMIT NË MENSA E  
KONVIKTE, BURSAT E SHTETIT DHE PAGESAT E NXËNËSVE E TË  
STUDENTËVE NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE, PËR VITIN  
SHKOLLOR 2014 - 2015”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, 19 e 28, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 57, të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të neneve 1 e 5, të ligjit nr. 10289, datë 17.6.2010, “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, të nenit 29, të ligjit nr. 8872, datë 29.3.2002, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Pika 15 e vendimit nr. 672, datë 7.8.2013, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

“15. Afati përfundimtar për shqyrtimin dhe miratimin e bursave, për vitet e para, është data 31 dhjetor 2014, për të gjitha kategoritë e shkollave, ndërsa për vitin e dytë e lart është data 15 nëntor 2014. Miratimi i bursave nga këshillat bashkiakë apo të komunës, për këtë vit shkollor, për të gjitha kategoritë e shkollave/institucioneve të arsimit të lartë, duhet të përfundojë deri në datën 30 prill 2015.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**